



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr. 1253 Prot.

Tiranë, më 4.12.2024

Lënda: **Informim dhe kërkesë për hetim të thelluar mbi keqinformimin zyrtar të institucioneve publike**

Drejtuar:

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

PROKURORES
ZNJ. ANTONETA SEVDARI

Për dijeni:

MINISTRIA E DREJTËSISË

BANKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

**PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT
TË ORGANIZUAR (SPAK)**

PROKURORES
ZNJ. DORINA BEJKO

Dhoma Kombëtare e Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë (*me tej Dhoma*) është thëllësisht e shqetësuar nga informacionet publike të dala në media, të cilat kanë nxjerrë në pah një pretendim të rremë të komunikimeve zhvilluar mes Bankës së Shqipërisë (*më tej BSH*) dhe Ministrisë së Drejtësisë (*më tej MD*), sipas të cilave Dhoma "*nuk ka përcjellë listën e përmbarduesve gjyqësorë zëvendësues*", listë që do të ndihmonte në heqjen e mijëra sekuestrove konservative të vendosura nga përmbardues që u ishte hequr licenca e ushtrimit të profesionit nga Ministria e Drejtësisë.

Ky pretendim i rremë, evidentohet në një komunikimin zyrtar të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (*më tej Prokuroria*

1



Tiranë), me bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet shkresës me nr. 19044 prot., datë 26.8.2024 “Dërgojmë informacion për heqjen e sekuestros të llogarive bankare”.

Në këtë shkresë konstatohet një keqinformim të Prokurorisë Tiranë nga dy institucionet ose njëri prej tyre, citohet:

“Ministria e Drejtësisë ka konstatuar se shumë përmbarues që kanë vepruar për llogari të shoqërive MCA dhe Final për mbledhjen e borxhit, kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin dhe u ka revokuar licencat. Për shkak të mosdorëzimit të dosjeve dhe për shkak të problemeve të tjera teknike nuk është bërë e mundur të vendosen përmbaruesit zëvendësues dhe për këtë arsye llogaritë e shumë qytetarëve prej vitesh kanë mbetur të bllokuara.

Banka e Shqipërisë më shkresën me nr. 5803, datë 22.8.2024, na ka njoftuar se: “për shkak se janë revokuar licencat e përmbaruesve pas marrjes në administrim të shoqërive MCA sh.p.k si dhe FINAL sh.p.k, nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Bankës së Shqipërisë janë administruar një numër i konsiderueshëm ankesash prej konsumatorëve të ndryshëm, kredimarrës apo bashkëkredimarrës, dorëzanës dhe jo të tillë, të cilët parashetrojnë shqetësimin se llogaritë e tyre bankare janë në sekuestro prej përmbaruesve të ndryshëm, kryesisht, Fatos Alimadhi, Altin Vako, Rigels Bejko, Helidon Xhindi, por jo vetëm, për llogari të subjekteve financiare (tashmë pa licencë) MCA sh.p.k si dhe FINAL sh.p.k. Në ankesat e depozituara ata pretendojnë se llogaritë janë nën sekuestro prej përmbaruesve, certifikatat e ushtrimit të profesionit të të cilëve janë të revokuara prej Ministrisë së Drejtësisë dhe një pjesë e tyre janë kallëzuar prej Ministrisë së Drejtësisë në prokurori për shkelje të ndryshme të dyshuara me natyrë penale. Në disa prej komunikimeve me Ministrinë e Drejtësisë, kuptohet se zëvendësimi i përmbaruesve licenca e të cilëve është revokuar nuk është bërë e mundur të kryhet, edhe pse detyrimi për këtë buron nga ligji për shërbimin përmbarimor privat. Sipas disa komunikimeve me Ministrinë e Drejtësisë, disa prej këtyre përmbaruesve nuk i kanë dorëzuar dosjet pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë nuk ka përcjellë listën me përmbarues zëvendësues në mënyrë që dosjet përmbarimore të vijojnë të trajtohen prej përmbaruesve të tjerë. Kjo ka sjellë që të mos kryhen më veprime përmbarimore për të hequr sekuestrot në rast të ekzekutimit të detyrimeve prej debitorëve të ndryshëm. Nga ana tjetër, në rastin e sekuestrove për llogari të institucioneve financiare jo banka MCA sh.p.k si dhe FINAL sh.p.k shumë kredimarrësve, garantorëve apo dorëzanësve, bashkëkredimarrësve etj. u kanë mbetur llogaritë bankare të sekuestruara, në disa raste duke ju mohuar edhe tërheqjen e pagës minimale prej llogarive bankare ku depozitohen prej punëdhënësve shumat e pagave nga punësimi.”

Për sa citohet në këto pasazhe të shkresës së Prokurorisë Tiranë, informacioni që japin dy institucionet (MD dhe BSH), veçanërisht ai që pasqyron të dhëna prej shkresës me nr. 5803, datë 22.8.2024 të BSH, është tërësisht i pavërtetë, i rremë dhe, në opinionin tonë, i dërguar qëllimisht për të keqinformuar organin e akuzës, që po zhvillon hetime për “skemën mashtruese me qëllim vjedhjen dhe zvatjen e qytetarëve”.

Dhoma, në përputhje me detyrimet e saj ligjore, ka dërguar zyrtarisht dhe periodikisht, konform kërkesave ligjore, Listën e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë Zëvendësues, listë që ka qëndruar gjithnjë e publikuar në faqen zyrtare të saj. Kjo listë është dërguar në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat” dhe udhëzimit nr. 11, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë “*Për miratimin e rregullave të hollësishme për modalitetet, afatet dhe mënyrën e caktimit të përmbauesit gjyqësor privat zëvendësues*”.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni për ilustrim, listën përkatëse të përmbauesve gjyqësorë private zëvendësues të vitit 2022, e cila nuk është përdorur nga MD. Kjo listë ka qenë jo vetëm e publikuar, por dhe e njoftuar zyrtarisht pranë MD-së me shkresën nr. 907 prot., datë 23.5.2022 “*Dërgohet lista e përmbauesve gjyqësorë privatë zëvendësues*”.

Pavarësisht gatishmërisë dhe korrektesës ligjore të Dhomës, evidentohet se Prokuroria Tiranë është keqinformuar nga BSH dhe MD mbi këtë fakt të rëndësishëm dhe publik, gjithnjë nëse pohimi zyrtar nëpërmjet shkresës me nr. 5803, datë 22.8.2024 të BSH, do të rezultojë i konfirmuar edhe prej MD-së.

Përmes keqinformimit të Prokurorisë Tiranë, vlerësojmë se është kërkuar të devijohen apo fshihen përgjegjësi konkrete nga hetimi që po zhvillon organi i akuzës dhe, jo vetëm.

Sa kohë është keqinformuar Kryeministria, Ministria e Financave apo institucione të tjera lidhur me këtë fakt, ky keqinformim është përdorur si bazë edhe për të propozuar ndryshime ligjore që cenojnë rëndë parimet themelore të ekzekutimit të detyrueshëm që lindën nga “alibia”: “*mungojnë përmbauesit gjyqësorë privatë zëvendësues – t’i zëvendësojmë me përmbaues shtetërorë*”.

E vërteta qëndron e faktuar krejt ndryshe. Në të gjitha rastet pas vitit 2019, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2019 “*Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat*” dhe parashikimit nëpërmjet tij të subjektit “përmbauesi zëvendësues”, kur është hequr licenca e një përmbauesi gjyqësor privat, urdhri përkatës i ministrit të Drejtësisë ka parashikuar emrin konkret të përmbauesit gjyqësor zëvendësues dhe afatin e dorëzimit të dosjeve dhe arkivës tek ky subjekt i përzgjedhur nga Lista e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë Zëvendësues.

Konkretisht:

1. Me urdhrin nr. 308, datë 2.5.2023 të ministrit të Drejtësisë, Fatos Alimadhit i hiqet licenca dhe përmbaues zëvendësues është caktuar duke u marrë nga lista z. Eduart Miftari.
2. Me urdhrin nr. 374, datë 29.5.2023 të ministrit të Drejtësisë, Lefter Canajt i hiqet licenca dhe përmbaues zëvendësues është caktuar duke u marrë nga lista znj. Klodiana Tabaj.
3. Në rastin e urdhrin nr. 380, datë 26.7.2022 të ministrit të Drejtësisë, “*Për heqjen e certifikatës përmbauesore dhe çregjistrimin nga regjistrat të përmbauesit gjyqësor privat Helidon Xhindi*”, ministri i Drejtësisë nuk caktoi asnjë përmbaues zëvendësues, edhe pse kishte listën me emra përmbauesish zëvendësues në dispozicion.

Ky veprim i paprecedentë, që ngarkon me faj të drejtpërdrejtë nëpunës të caktuar brenda MD, të cilët kanë hartuar, miratuar dhe dërguar për formalizim aktin të ministrit të Drejtësisë, pa vendosur emrin e një përmbaruesi zëvendësues siç e kërkon ligji, ka rezultuar në pasoja të mosadministrimit të mijëra dosjeve dhe arkivës së ish-përmbaruesit Helidon Xhindi.

- Përse u shmang detyrimi për caktimin e një përmbaruesi zëvendësues, ndryshe nga çdo rast tjetër, në rastin “Helidon Xhindi”?
- A ishte ky një akt i qëllimshëm që ka kontribuar në krijimin e situatës kaotike të mijëra sekuestrove aktive për shkak të mijëra dosjeve të padorëzuara prej këtij përmbaruesi, mes të cilave edhe dosja e rastit fatkeq “Pal Trashaj”?

Kërkojmë nga Prokuroria Tiranë, të hetojë menjëherë në drejtim të këtyre pyetjeve, duke gjetur edhe përgjegjësit për keqinformimin e saj, të paktën për rastin “Helidon Xhindi”, për të cilin, provohet nëpërmjet urdhrin nr. 380, datë 26.7.2022 të ministrit të Drejtësisë se, nuk është caktuar asnjë përmbarues gjyqësor privat zëvendësues për heqjen e mijërave sekuestrove, duke degraduar qëllimisht situatën e mosadministrimit të dosjeve dhe arkivës së tij.

Sa i përket informacionit që Prokuroria Tirane ka dërguar drejt bankave të nivelit të dytë përmes shkresës me nr. 19 044 prot., datë 26.8.2024, në përmbajtje të saj konstatohet edhe një kërkesë me qëllimin pozitiv që të ndërpriten pasojat e veprave penale të kryera ndaj mijëra qytetarëve për shkak të mbajtjes së sekuestruar të llogarive bankare të tyre, citojmë si vijon pasazhin nga kjo shkresë:

“Kërkojmë nga ana Juaj heqjen e sekuestrove të vendosura mbi llogaritë e të gjithë qytetarëve (individëve), nga përmbaruesit të cilëve u është hequr licenca dhe për të cilët jeni njoftuar zyrtarisht (nga Ministria e Drejtësisë), që ka të bëjë me urdhrat e ekzekutimit të lëshuara për llogari të shoqërive “Micro Credit Albania” me Nuis L41729001H dhe Final me Nuis K81311012P.”

Dhoma, inkurajon përpjekjet për të lehtësuar apo ndihmuar në zgjidhjen e problemit shqetësues të mijëra qytetarëve. Por nga ana tjetër përcjell me shqetësim mënyrat ligjore të gjetjes së zgjidhjeve adekuate në këtë drejtim.

Dhoma ka kërkuar me forcë zgjidhjen e kësaj situatë kriminale para organeve shtetërore përfshirë MD dhe BSH, duke i vënë në dijeni të plotë mbi fenomenin e paprecedentë:

- ✚ Ku “mijëra llogari bankare të klientëve që përdorëshin për kryerje pagesash, në llogari rrjedhëse, krediti, depozite, llogari buxhetore dhe/ose llogari page” u bllokuan nga akte/shkresa përmbarimore të adresuara nga kutia postare nr. 7469 Tiranë, të mbyllura në zarfe postare me logon ADCA.
- ✚ Kur llogaritë e qytetarëve, përfshirë edhe llogaritë e pagave, u mbajtën të bllokuara pa afat me fonde të sekuestruara në masën 100%.
- ✚ Kur u verifikua se u sekuestruan me qindra llogari page debitorësh të MCA, filluar nga muajt shkurt-mars-prill-maj-qershor 2022, duke cenuar rëndë minimumin jetik të qytetarëve të bllokuar; duke shkaktuar probleme të rënda financiare në familjet e tyre dhe duke krijuar direkt probleme sociale dhe psikologjike për shumë ndër ta.

- ✚ Kur bankat e nivelit të dytë, veçanërisht Banka Kombëtare Tregtare (BKT) bllokuan në masë fondet e qytetarëve me shkresa “Sekuestro konservative” të regjistruara me kredenciale përmbauesish (Helidon Xhindi, Fatos Alimadhi, Lefter Canaj), por në asnjë rast nuk transferuan shumat e sekuestruara edhe pse ekzistonte një afat konkret ligjor 10-ditor për të kryer këtë veprim, bazuar në udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2014 të Bankës së Shqipërisë “*Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë*”.
- ✚ Kur pas marrjes së “urdhrit” dhe vendosjes së sekuestros konservative (të gjitha fiktive) nga tre përmbauesit e “kutisë postare nr. 7469”, bankat bllokuan miliona lekë vlera monetare nëpër llogaritë dhe depozitat e mijëra qytetarëve, duke patur dijeni të plotë mbi çfarë po ndodhte dhe, duke patur dijeni mbi udhëzimin e BSH, që i detyronte në formë taksative: pas më shumë se 10 ditësh pune, nëse përmbauesi nuk urdhëron transferimin e shumës ose heqjen e sekuestros për këtë shumë, sekuestroja bie, duke bërë që llogaritë të çlirohen/zhbllokohen.

Dhoma vuri në dijeni autoritetet shtetërore që bankat nuk po zbatonin detyrimet ligjore duke mbajtur të bllokuara dhjetëra apo qindra llogari bankare për disa muaj rresht në masën 100% duke i vendosur “të bllokuarit” para faktit anonim, me shkresa/njoftime pa emër, mbiemër, vulë dhe pa asnjë kredencial titullari apo përfaqësuesi thjesht, me shënimin “Ju është bllokuar llogaria”, pa treguar asnjë të dhënë informuese që do të mundësonte qytetarët për të kryer ankime gjyqësore apo administrative. Ky shënim jo informues, u konstatua të përdorej në masë të dhjetëra qytetarë nga ana e BKT.

Dhoma konsideroi atëherë, dhe vijon të mbajë të njëjtin qëndrim sot se, ky ishte një bashkëpunim mes bankave dhe subjekteve nën hetim që së bashku u përfshinë në këtë veprimtari kriminale me pasoja të rënda ekonomike dhe psikologjike për qytetarët.

Në disa qëndrime të qarta zyrtare prej dy vitesh më parë, me shkresat nr. 862 prot., datë 18.2.2022; nr. 896 prot., datë 8.4.2022; nr. 945 prot., datë 17.8.2022; nr. 944 prot., datë 12.8.2022; nr. 959 prot., datë 14.9.2022”, Dhoma evidentoi dhe kërkoi me forcë zgjidhjen e këtij problemi masiv.

Mes këtyre shkresave dhe qëndrimeve, po shkëpusim disa pasazhe nga shkresa nr. 862 prot., datë 18.2.2022 me lëndë: “*Për zbatimin dhe respektimin rigoroz të dispozitave ligjore që lidhen me ekzekutimin e detyruar nga bankat tregtare në vend*”, drejtuar 12 bankave tregtare të licencuara në vend. Kjo shkresë është vënë në dijeni të ministrit të Drejtësisë dhe drejtueses së Prokurorisë Tiranë. Dhoma, nëpërmjet kësaj shkrese, pasi ka shpjeguar për sa ka konstatuar prej ankesave të qytetarëve lidhur me situatën e krijuar ka kërkuar, citojmë:

[...] kërkohet nga të gjitha bankat tregtare në vend:

-Të adresojnë menjëherë problematikën e hasur dhe dokumentacionin përkatës në organet ligjzbatuese në vend, sa kohë kanë dijeni të plotë mbi riciklimin e mijëra çështjeve të vjetra bankare dhe përmbareshme të risjella në treg në formën e një skeme mashtrimi, që po shkakton pasoja të rënda sociale për publikun, qytetarët si dhe për vetë sistemin bankar.

-Të bashkëpunojnë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare për identifikimin e të gjithë rasteve që kanë adresuar të njëjtën problematikë:

shkresa/akte përmbaruesi që shënojnë “kuti postare” dhe jo adresën e vendit, ku zhvillohet veprimtaria përmbarimore.

-Të lirohen të gjitha llogaritë e shtetasve të përcaktuar si debitorë që mbahen të bllokuara tej afateve ligjore të përcaktuara në udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2014 “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”.[...]

Me shkresën nr. 959 prot., datë 14.9.2022 me lëndë: “Për lirimin e menjëhershëm të llogarive bankare të bllokuara nga ana e BKT-së, për shkak të administrimit të mijëra sekuestrove përmbarimore dhe ndalimin e bashkëpunimit në një veprimtari të organizuar kriminale me dëm masiv publik”, drejtuar Bankës Kombëtare Tregtare, Dhoma ka vënë në dijeni, ministrin e Drejtësisë, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, drejtuesin e Prokurorisë së Tiranës, disa ankues mes tyre edhe të ndjerin Pal Trashaj.

Mes të tjerash në këtë shkresë Dhoma evidenton se, citojmë:

[...] jeni orientuar disa herë për të marrë masa urgjente për ndalimin e këtij fenomeni kriminal; përsëri llogaritë e qindra mijëra qytetarëve vijnë të mbahen të bllokuara nga ana e bankës suaj, në shkelje të hapur të çdo parashikimi ligjor.[...]

[...] në kushtet kur mbajtja e bllokuar e llogarive të tyre bankare në mënyrë të paligjshme nga banka, i shërben direkt qëllimit për shtrëngimin e tyre për kredimarrje të re pranë subjekteve të lidhura me këtë skemë kriminale.[...]

[...] Ju ftojme të lironi menjëherë dhe brenda 5 (pesë) ditëve të gjitha llogaritë e shtetasve të përcaktuar si debitorë që mbahen të bllokuara tej afateve ligjore të përcaktuara në udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2014 “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”, për të mos u kthyer në bashkëpunëtorë të një veprimtarie të organizuar kriminale me dëm masiv publik.[...].

Asnjë nga këto shkresa dhe kërkesa të vazhdueshme të Dhomës, nuk u konsiderua nga institucionet bankare dhe ato të vëna në dijeni për dy vite rresht.

Po kështu edhe ministri i Drejtësisë reagoi me shkresën nr. 935/4 prot., datë 22.7.2022 “Për zbatimin me rigorozitet të dispozitave ligjore që lidhen me ekzekutimin e detyruar nga bankat tregtare ne vend” , duke i kërkuar Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko që si organi mbikëqyrës i sistemit bankar, të orientonte bankat tregtare në vend për të zbatuar me rigorozitet dispozitat ligjore në fuqi.

BSH, nga ana e saj me shkresën nr. 6671 prot., datë 19.9.2022 përcolli te bankat, mesazhin e ministrit të Drejtësisë dhe të Dhomës, por në formë evazive dhe në asnjë rast nuk kërkoi zbatimin prej tyre me rigorozitet të aktit rregullativ që e kishte nxjerrë dhe duhet ta mbikëqyrte po vetë: udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2014 të Bankës së Shqipërisë “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”.

- Përse nuk u zbatuan detyrimet ligjore nga bankat e nivelit të dytë deri me dërgimin e shkresës me nr. 19044 prot., datë 26.8.2024 të Prokurorisë Tiranë?

- Çfarë elementi të ri solli kjo shkresë e gushtit 2024 për bankat, në kuptim të zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore, për të cilat ishin njoftuar dhjetëra herë më parë filluar që nga shkurti 2022?

Kërkojmë nga Prokuroria Tiranë, të hetojë menjëherë në drejtim të këtyre pyetjeve, duke gjetur edhe përgjegjësit për krijimin e kësaj situate të paprecedentë, të cenimit të interesave financiare të mijëra qytetarëve shqiptarë, që u bllokuan me akte fiktive përmbartimore nëpër bankat e nivelit të dytë, të cilat nuk respektojnë aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë dhe, as nuk e adresuan problemin në organet kompetente për zgjidhjen e tij, por e mbajtën të izoluar brenda sektorit bankar, së bashku me llogaritë e mijëra qytetarëve që filluan të zhblokohen vetëm pas shtatorit 2024, deri me dërgimin e shkresës nr. 19044 prot., datë 26.8.2024 të Prokurorisë Tiranë.

Nëse udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2014 *“Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”* i Bankës së Shqipërisë nuk është zbatuar për dy vjet rresht, pas njoftimeve dhe kërkesave të shumta të Dhomës, më pas edhe kërkesës së MD që njoftoi BSH, atëherë protagonistët e moszbatimit të tij në bankat e nivelit të dytë, duhet të vendosen para përgjegjësive, për sa kohë respektojnë pa asnjë mëdyshje një shkresë informuese të Prokurorisë Tiranë, që nuk shkruante as një rresht më shumë, përveç se çfarë që kishte shkruar, Dhoma, ministri i Drejtësisë apo Guvernatori i Bankës së Shqipërisë në shkresat respektive zyrtare ku kërkohej respektimi i aktit rregullator, udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2014. Që të gjitha shkresat kërkonin në formë të përbashkët, drejtpërdrejt apo tërthorazi, çlirimin e llogarive të qytetarëve nëpërmjet respektimit të ligjit.

Shkresa me nr. 19044 prot., datë 26.8.2024 e Prokurorisë Tiranë, përveç problemeve të evidentuara si më sipër, konstaton edhe një përgjegjësi tjetër ligjore që buron nga informacioni që MD ka përcjellë për Prokurorinë Tiranë, ndërsa e lidh *“Mosdorëzimin e dosjeve nga përmbartuesit që kanë vepruar në interes të MCA e që iu është hequr licenca me probleme të tjera teknike”*.

Dhoma, me shkresën nr. 1187 prot., datë 29.2.2024 *“Mbi marrjen e masave urgjente për gjetjen dhe administrimin e mijëra dosjeve/çështjeve përmbartimore, vulës personale dhe arkivës së krijuar prej fillimit të veprimtarisë së tyre, nga ish-përmbartuesit gjyqësorë privatë Lefter Canaj, Helidon Xhindi dhe Fatos Alimadhi”* (bashkëlidhur), ka evidentuar këto *“probleme teknike”* të cilat nuk duhet të ekzistojnë nëse do të zbatoheshin drejtpërdrejt ligji dhe jo fshehja pas burokracisë së tij.

Për të tre ish-përmbartuesit (Helidon Xhindi, Fatos Alimadhi, Lefter Canaj) të përfshirë në skemën e mashtrimit të MCA dhe Final, pas heqjes së licencave, MD zhvilloi e pashqetësuar procedura të një rutine të pashqetësuar administrative, megjithëse mosdorëzimi i tre vulave dhe mijëra dosjeve përmbartimore (12 000) nga ana e tyre, ishte një akt i paprecedentë me ngarkesë të dukshme penale, që kishte sjellë dhe do të vazhdonte të sillte pasoja akoma më të rënda për mijëra qytetarë, ashtu si në fakt ndodhi.

Mosveprimet e MD përbëjnë një shkelje të rëndë të detyrimeve ligjore sa kohë, çështja e mijëra dosjeve të padorëzuara që mbanin të dhënat juridike dhe financiare të mijëra qytetarëve u konsiderua si çështje *“teknike”* dhe u trajtua dhe përfundoi:

- nga zyrat e MD-së nga ku dolën tre urdhrat administrativ për heqjen e tre licensave të përmbaruesve, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, para së cilës MD kërkoi nxjerrjen e tre urdhrave të ekzekutimit, për zbatimin e tre urdhrave të ministrit të Drejtësisë; më pas
- në Zyrën e Përmbarimit Tiranë ku u kërkua nga tre përmbarues gjyqësorë shtetërorë të ekzekutonin vendime të gjykatës për gjetjen e dosjeve dhe vulave të tre ish-përmbaruesve gjyqësorë privatë.
- Tre përmbaruesit shtetërorë pasi nuk mundën të ekzekutonin (gjenin) asnjë dokumentacion përmbarimor dhe as vetë ish-përmbaruesit, i referuan të tre çështjet përmbarimore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kundër tre ish-përmbaruesve privatë për veprën penale të parashikuar në nenin 320 të Kodit Penal “Pengimit të ekzekutimit të vendimeve të gjykatës”.

Ndërkohë që pritej të përfundonte kjo zgjidhje “teknike” administrative, me mijëra qytetarë vuajtën efektet e mungesës së një zgjidhje të vërtetë dhe të shpejtë ligjore, si ajo e bashkëpunimit ndërinstytucional efektiv për gjetjen dhe marrjen në dorëzim të dosjeve përmbarimore, nëse ato ishin në të vërtetë në duart e ish-përmbaruesve të cilët refuzonin bashkëpunimin me MD.

Në dijeninë tonë, tre prokurorë të ndryshëm të Prokurorisë Tiranë, kanë hetuar për tre çështjet në ngarkim të tre ish-përmbaruesve gjyqësorë privatë të kallëzuar nga Zyra e Përmbarimit Tiranë për mosdorëzimin e dosjeve dhe vulave, por nuk kanë gjetur ende një përfundim ligjor, përveç çështjes së ish-përmbaruesit Lefter Canaj, për të cilin jemi informuar se prokurori përkatës, ka marrë vendim “Për mosfillimin e çështjes penale”, vendim i ankimuar më pas nga kallëzuesi – përmbaruesi gjyqësor i Zyrës së Përmbarimit Tiranë.

Dokumentacionin e detajuar të siguruar për këtë kalvar të veprimtarisë burokratike institucionale të evidentuar sa më sipër, do ta gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese (*gjithsej 67 fletë*).

Sa i përket përgjegjësiwe institucionale duhet të evidentojmë edhe një problem brenda gjithë problematikës së krijuar ndër vite lidhur me çështjen objekt hetimi, e për të cilën “zëri” i Dhomës nuk është dëgjuar në asnjë rast:

Në datë 4.2.2020, ministres së Drejtësisë Etilda Gjonaj (Saliu) i është dorëzuar një raport “Për evidentimin, gjetjet dhe konstatimet e procesit të dorëzimit të dokumentacionit dhe arkivave përmbarimore të padorëzuara të përmbaruesve gjyqësorë privatë” nga një grup pune, i përbërë prej 3 inspektorë të MD dhe 3 anëtarë të Dhomës.

Raporti përfundonte me propozime, rekomandime dhe përgatitjen për referimin e disa veprave penale në prokurori dhe evidentoi faktin se, në Ministrinë e Drejtësisë në ambientet e pritjes me publikun në datën 28.10.2019, u braktisën nga persona të panjohur, 104 thasë prej qesesh të zeza me materiale përmbarimore, dosje dhe arkiva të përmbaruesve të “Shërbimit Përmbarimor ZiG”, “Shërbimit Përmbarimor STAR/FS” dhe “Shërbimit Përmbarimor FLASH”.

Nga procesverbali i verifikimit dhe inventarizimit fizik të dokumentacionit të braktisur, u konstatuan materiale dokumentare të 5 800 dosjeve përmbarimore me status “aktive” ose “të pushuara”, që përmbanin materiale origjinale, bashkë me urdhra ekzekutimi të fotokopjuar (jo origjinal), që u përkisnin përmbarueseve të cilëve u ishte hequr licenca (2017-2018), e që ishin pjesë e tre shoqërive.

U konstatua gjithashtu se, 4 944 dosje/çështje përmbarimore të tjera që u përkisnin këtyre shoqërive, rezultojnë ende të padorëzuara.

Sa kohë Ministri i Drejtësisë Etilda Gjonaj (Saliu), bazuar në raportin e grupit të punës depozitoi kallëzimin penal me shkresën nr. 1029/1 prot., datë 19.2.2020, ky kallëzim nuk u shoqërua edhe me provat/materialet dokumentare të pasqyruara në të, pra nuk u shoqërua me materialin dokumentar që gjendej në 5 800 dosjet përmbarimore që duhet të hetoheshin për të dhënat që përmbanin.

Dosjet dhe materiali përmbarimor nuk u dërgua në zyrat e organit të akuzës, por u la i magazinuar në bodrumin e Ministrisë së Drejtësisë për katër vite, aty ku ndodhet edhe sot.

Me dhjetëra ankues me statusin e debitorit kërkuan pranë MD ku gjendeshin dosjet – objekt ankese, heqjen e sekuestrove edhe pse kishin paguar detyrimet, por MD nuk ndërmoi asnjë veprim përveç atij të magazinimit.

Shumë kreditorë, mes tyre banka, kërkuan të rishpërndaheshin çështjet përmbarimore që gjendeshin në këtë grupim prej 5 800 dosjesh, por përsëri MD qëndroi pasive duke mos ndërmarrë asnjë iniciativë praktike dhe as konform ligjit, kryesorja, për dorëzimin e kësaj prove kryesore materiale në duart e organit të akuzës, i cili do të vlerësonte mbi dokumente origjinale dhe dosje përmbarimore dinamikën e hetimit dhe/ose do të nxirrte orientime ligjore si ky që dërgoi nëpërmjet shkresës nr. 19044 prot., datë 26.8.2024 “*Dërgojmë informacion për heqjen e sekuestros të llogarive bankare*”.

Jemi informuar se, ambienti (bodrum) i Ministrisë së Drejtësisë, aty ku ndodheshin 5 800 dosjet përmbarimore, para një viti rezultoi i hapur nga persona të paidentifikuar dhe për këtë problem është thirrur për të hetuar dhe këqyruar vendin e ngjarjes Policia e Shtetit. Nuk kemi informacione nëse janë konstatuar nga autoritete të MD-së shenja të cenimit dokumentar të këtyre dosjeve, por jemi informuar se ngjarja është referuar në Prokurorinë Tiranë.

Nga të dhënat e përftuara përgjatë këtyre viteve rezultojnë se, 12 000 dosje përmbarimore mbeten të padorëzuara nga tre ish-përmbaruesit të cilëve iu hoq licenca në korrik 2022 dhe prill-maj 2023; 4 944 dosje përmbarimore u evidentuan si të padorëzuara nga ish-përmbaruesit e shoqërive “Shërbimi Përmbarimor ZiG”, “Shërbimi Përmbarimor STAR/FS” dhe “Shërbimi Përmbarimor FLASH”, në shkurt 2020; 5 800 dosje përmbarimore gjenden ende në bodrumin e Ministrisë së Drejtësisë.

Ky është një numër shumë i madh dokumentesh që kanë shkaktuar pasoja financiare – ekonomike, për një numër akoma më të madh qytetarësh.

Procesi i ndjekjes burokratike administrative të këtij problemi nga ana e MD, tashmë i kthyer në **problem publik**, evidenton qartë se Dhoma, ligji “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, apo “Përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues” nuk kanë patur asnjë efekt apo “faj” për zgjidhjen e tij.

Për rastin “Helidon Xhindi” pasojat dhe faktorët do të lidheshin dhe do të gjendeshin menjëherë tek mosçaktimi i përmbaruesit zëvendësues, por kjo nuk ishte e njëjtë për dy rastet që i përkasin procedurës së ndjekur nga MD për ish-përmbaruesit Lifter Canaj dhe Fatos Alimadhi, për sa kohë për të dy u caktuan dy emra përmbaruesish zëvendësues, por që nuk u përdorën në asnjë prej të dy rasteve, sepse u refuzua dorëzimi i mijëra dosjeve dhe dy vulave nga ish-përmbaruesit, ndërsa MD refuzoi të zbatonte detyrimet ligjore që parashikohen për zyrtarin publik, kur konstaton kryerjen e një vepre penale, që po cenonte aktivitetin publik e për më tepër interesat e një numri tepër të madh qytetarësh.

Kjo situatë ka çuar në shkelje të drejtpërdrejta të të drejtave të qytetarëve dhe kredimarrësve, duke krijuar një krizë besimi në gjithë sistemin e drejtësisë, sistemin bankar dhe, veçanërisht në shërbimin përmbarimor shqiptar.

Dhoma kërkon të theksojë se:

- Keqinformimi i Prokurorisë Tiranë nga dy institucionet (MD dhe BSH) lidhur me ekzistencën e “problemeve teknike” apo mungesën e “përmbaruesit privatë zëvendësues” nuk mund të shihen si lapsus apo gabim administrativ, por si një devijim i qëllimshëm që ka synuar shmangien e përgjegjësive konkrete për mosveprimet për një kohë të gjatë nga ana e të dy institucioneve, të cilat më pas, për të justifikuar mosveprimin permanent ndër vite dhe pasojat e shkaktuara tek mijëra qytetarë nga mosveprimi permanent i tyre, gjetën “zgjidhjen dhe alibinë” tek ndryshimet ligjore apo rregullatore, që jo vetëm cenojnë rëndë shërbimin përmbarimor gjyqësor privat nga njëra anë, por nuk ndihmojnë në zgjidhjen e problemit tepër të rëndë, që mbetet po aty, nga ana tjetër.

Devijimi i informacionit ndaj Prokurorisë Tiranë vlerësojmë se, ka sjellë pasojat të rënda jo vetëm për hetimin, por edhe për orientimin e gjetjes së zgjidhjes për të minimizuar efektet që kanë krijuar mijëra dosje fiktive përmbarimore tek qytetarët e prekur prej tyre, por jo pak ka ndikuar edhe për integritetin e vetë organeve shtetërore që duhet të garantojnë ligjshmërinë dhe sigurinë juridike.

Ministria e Drejtësisë dhe Banka e Shqipërisë duhet të bëjnë menjëherë **një sqarim publik dhe transparent** për veprimet dhe deklaratat e tyre në lidhje me këtë çështje.

Dhoma ka qëndruar e paangazhuar publikisht, nga maji 2024 e më pas, me qëllimin e vetëm për t’i lënë fjalën e radhës hetimit, edhe pse shpesh ka dëgjuar fajësimin e padrejtë të saj nga prononcime mediatike dhe publike të përfaqësuesve të MD, BSH apo dhe të AAB (Shoqata Shqiptare e Bankave), në lidhje me situatën e krijuar prej skemës kriminale që po heton Prokuroria Tiranë, e që është vetë Dhoma, e cila e ka ekspozuar shumë herë fenomenin kriminal, me qëndrimet publike dhe zyrtare filluar prej vitit 2015, duke e ka kallëzuar penalisht dy herë para SPAK, në shkurt 2022 dhe nëntor 2023.

Për Dhomën, i gjithë fenomeni dhe protagonistët e përfshirë në të, është një veprimtari kriminale që në kuptim të nenit 334 të Kodit Penal është kryer nga një organizatë e mirëfilltë dhe grup i strukturuar kriminal, organizatë të cilën e kemi kallëzuar para SPAK, bashkë me 16 subjekte (persona fizikë dhe juridikë) brenda saj.

Dhoma do të vijojë të monitorojë nga afër situatën dhe të mbrojë me vendosmëri integritetin e shërbimit përmbartimor privat në Shqipëri. Kjo çështje nuk është vetëm një test për respektimin e ligjit, por një garanci për sigurinë juridike dhe të drejtat e qytetarëve të këtij vendi.

Përfundimisht kërkojmë veprim të menjëhershëm dhe hetim të thelluar nga Prokuroria Tiranë, e cila po heton prej shkurtit 2020 një skemë mashtruese kriminale, me pasoja tepër të rënda për shumë qytetarë shqiptarë, skemë e cila do të duhet të vendoset para një përfundimi ligjor, që më pas të jetë jo vetëm përgjigje, por edhe lehtësim por dhe rrugëzgjdhje për mijëra qytetarë.

KRYETARI I DHOMËS

TEDI MALAVECI